




REPUBLIKA E KOSOVës / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. 01-3108/13
Dep. 02	Data 01.10.2013
Nr. i fau	Titulli
Broj stranice	Qëllimi
Nr. pages	Qëllimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	01/10/2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Ekrem MALIQI u.d. Drejtor i Prokurimit, Ministria e Shëndetësisë
CC:	z. Gani SHABANI u.d. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion për Tenderin "Furnizim me produkte farmaceutike nga L.E"



Të nderuar!

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin "Furnizim me produkte farmaceutike nga L.E", me nr. të prokurimit: 206-13-088-111, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues, që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Furnizim me produkte farmaceutike nga L.E" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Zyra e Prokurimit nga Ministria e Shëndetësisë më datë 10/09/2013 ka përgatitë “Njoftim Kontrate” me titullin: “Furnizim me produkte farmaceutike nga L.E”, me nr. të prokurimit: 206-13-088-111, e cila po ashtu është publikuar në faqen elektronike të KRPP-ës më datë 10/09/2013 si Kontratë Publike Kornizë 24 Mujore.

Në “Njoftim Kontrate” të publikuar në KRPP më datë 10/09/2013, tek pika III.2.4 e rubrikës “Kapaciteti Teknik dhe Profesional”, në pikën e pestë sipas radhitjes kërkohet: Dëshmi se preparati është i regjistruar në së paku një vend të Schengen-it, Britani e madhe, Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Izrael, Australi, Turqi.

Mënyra e përpilimit të kërkesave në “Dosja e Tenderit” tek “Kapaciteti Teknik dhe Profesional” cakton vendin e origjinës për produktet, në këtë mënyrë mund të favorizohet ndonjë OE ose të diskriminohet ndonjë tjetër. Bazuar në legjislacionin e vendit dhe ligjeve në fuqi, një gjë e tillë nuk është e lejuar dhe nuk i jep hapësirë konkurrencës së lirë dhe legale.

Autoriteti Kontraktues në këtë procedurë prokurimi si kriter për dhënien e Kontratës ka paraparë kriterin për tenderin “Ekonomikisht më të favorshëm”. Në këtë procedurë ka paraqitur të njëjtat kritere si në “Kriteret e Dhënies” po ashtu edhe në “Kriteret e Përzgjedhjes”. Autoriteti Kontraktues duhet të siguroj dallimin e qartë në mes kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve për dhënien e Kontratës. Në “Kriteret e Dhënies”, janë paraqitur tre nën-kritere ku shuma e përgjithshme e tyre jep shumën 120% (70%+30%+20%). Aneksi 6 në “Dosja e Tenderit” pika 3 thotë: Pesha e dhënë secilës nga kriteret (në % - totali i të gjitha peshave duhet të jetë i barabartë me 100)

Konsiderojmë se një shkelje e tillë, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, bien ndesh me Nenin 7, Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi; nenin 27 Dosja e Tenderit; nenin 52, Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës dhe 23.5 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Me respekt!